

SHPENZIMET E DREJTORIVE SIPAS KATEGORIVE

Krahasimi i shpenzimeve për
vitet 2022-2023

JANAR 2024



**Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Hyrje

Në këtë raport janë paraqitur shpenzimet e bëra për dy vitet paraprake vitin 2022 dhe 2023 për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për secilën drejtori/njësi.

Në raport krahasohen shpenzimet në kategoritë e: Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale, Subvencioneve dhe Shpenzimeve Kapitale brenda secilës drejtori/njësi për vitet 2022 dhe 2023

- Kategoria e shpenzimeve që ka pasur rritje në secilën drejtori apo njësi/sector ishin pagat me një rritje mesatare prej 29.7% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

- Investimet kapitale nëse merret mesatarja për të gjitha drejtoritë përgjatë vitit 2023 ishin rritur mesatarish për 335 %krahasuar me një vit më parë atë 2022. Kjo kishte ndodhur si pasojë e asaj që në Drejtorinë e Urbanizmit ishin rritur investimet kapitale në vitin 2023 për 2555 % në raport me vitin 2022 apo shprehur në vlerë monetare diferenca e rritjes ishte për 144,340 € më shumë se në vitin 2022, pra kjo ka ndikuar që mesatarja e përqindjes për investime kapitale është më e rritur se zakonisht.

- Rritje të konsiderueshme kanë pasur edhe shpenzimet në kategorinë e Subvencioneve me një rritje mesatare prej 76.29 %.


- Shpenzimet në kategorinë Mallra dhe Shërbime po ashtu ishin rritur në vitin 2023 në raport me vitin 2022 mesatarisht për 31.80 %.

TABELË PËRMBËEDHËSE E SHPENZIMEVE PËR TË GJITHA KATEGORITË SIPAS DREJTORIVE/SEKTORËVE PËR VITIN 2022 DHE 2023

DRJRETORIA/SEKTORI	PAGAT		MALLRA DHE SHËRBIME		SHPENZIMET KOMUNALE		SHPENZIMET KAPITALE		SUBVENCIONET	
	SHPENZIMET 2022	SHPENZIMET 2023	SHPENZIMET 2022	SHPENZIMET 2023	SHPENZIMET 2022	SHPENZIMET 2023	SHPENZIMET 2022	SHPENZIMET 2023	SHPENZIMET 2022	SHPENZIMET 2023
KRYETARI-ASAMBLEJA KOMUNALE	227,956.60	306,549.83	99,914.37	102,360.58					1,990,053.87	3,508,216.34
ADMINISTRATA DHE PERSONELI	449,916.73	477,867.80	999,625.96	1,105,300.86	83,917.08	717,953.32	88,250.80	104,862.42		
INSPEKSIONI	134,547.59	186,687.47	98,562.00	60,790.82			-	-	-	-
ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	170,772.36	357,757.94	-	-	-	-	-	-	-	-
BUXHET DHE FINANCA	215,845.66	242,427.05	348,428.97	358,485.78	46,756.99	-	-	30,000.00	-	-
SHËRBIMET PUBLIKE	480,125.41	643,105.39	2,601,029.79	3,573,536.51	335,591.32	477,831.88	8,355,842.18	13,580,300.65	-	-
ZYRA E KOMUNITETEVE	36,618.09	37,432.57	29,999.75	39,335.33						
BUJQËSIA	115,371.01	129,212.26	278,676.22	214,352.57			226,084.47	387,242.00	544,033.72	
ZHVILLIMI EKONOMIK-TURIZMI	31,812.10	45,787.40	108,994.48	105,552.40			239,306.11	375,627.94		
KADASTËR DHE GJEODEZI	96,972.35	120,225.49	11,200.00	21,219.80						
PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	81,918.55	105,616.38	268,847.40	548,556.68			5,660.00	150,000.00		
KULTURË, RINI DHE SPORT	226,353.97	353,674.16	245,728.82	784,801.98			389,464.75	1,154,706.34	28,300.00	29,750.00
SHËRBIMET SOCIALE	238,932.45	245,924.81	773,147.05	898,419.29	1,103.34	587.56	213,355.54	138,840.00		
ARSIMI	14,748,450.36	17,914,855.99	2,821,164.38	2,410,177.66	228,849.87	224,971.97	1,279,102.18	2,314,577.57		
SHËNDETËSIA	3,843,120.88	4,541,884.90	1,450,419.83	1,607,006.72	121,910.46	149,404.45	854,904.92	964,320.54		
GJITHSEJ	21,098,714.11	25,709,009.44	10,135,739.02	11,829,896.98	818,129.06	1,570,749.18	11,651,970.95	19,200,477.46	2,562,387.59	3,537,966.34

KRYETARI DHE ASAMBLEJA KOMUNALE


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Sipas të dhënave të paraqitura grafiksht, shpenzimet e vitit 2023 krahasuar me vitin 2022 kanë janë rritur në të gjitha kategoritë dhe veçanërisht vërehet një rritje më e theksuar në kategorinë e subvencioneve me 76.29 % krahasuar me vitin 2022

DREJTORIA E ADMINISTRATËS


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet në Drejtorinë e Administratës për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 janë më të larta. Rritje e konsiderueshme vërehet tek shpenzimet komunale ku në vitin 2023 shpenzimet për këtë kategori janë rritur për 755.55 %.

DREJTORIA E INSPEKTORATEVE


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Në Drejtorinë e Inspektorateve gjatë dy viteve paraprake 2022 dhe 2023 ka vetëm dy kategori të shpenzimeve ajo e pagave dhe mallrave. Shpenzimet e pagave në vitin 2023 janë rritur për 38.75 % ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 kanë pësuar rënie prej 38.32 % krahasuar me vitin 2022. Ndërsa në tri kategoritë tjera nuk ka pasur shpenzime.

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet e Zyrës së Kuvendit Komunal gjatë viteve 2022 dhe 2023 janë vetëm në kategorinë e pagave shpenzime të cilat në vitin 2023 janë rritur për 109.49 % apo 186,985.58 € më shumë krahasuar me vitin 2022.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet e ndodhura gjatë viteve 2022 dhe 2023 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa kanë pësuar rritje për disa kategori dhe zvogëlim për një kategori tjetër. Në kategorinë e pagave në vitin 2023 ka një rritje prej 12.31 % krahasuar me vitin 2022, shpenzimet për mallra dhe shërbime po ashtu kanë pasur një rritje të lehtë në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 prej 2.89 %, shpenzimet komunale në vitin 2023 kanë qenë 0 € krahasuar me vitin 2022, po ashtu shpenzimet kapitale në vitin 2023 kanë qenë 30,000 € ndërsa në vitin 2022 këto shpenzime ishin 0 €.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë si vijon: në kategorinë e pagave shpenzimet janë rritur për 33.95 % apo 162,979,89 € më shumë se në vitin 2022, po ashtu shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 janë rritur për 37.39 % apo për 972,506.72 € më shumë se në vitin 2022 edhe shpenzimet komunale në vitin 2023 janë rritur për 42.39 % apo për 142,240.56 € më shumë e në vitin 2022. Kategoria e shpenzimeve e cila ka pasur një rritje më të dukshme në raport me vitin 2022 janë shpenzimet për investime kapitale ku në vitin 2023 këto shpenzime janë rritur për 62.52 % krahasuar me vitin 2022 apo 5,224,458.47 € më shumë se në vitin 2022.

ZYRA E KOMUNITETEVE


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Në Zyrën për Komunitete gjatë viteve 2022 dhe 2023 ka pasur vetëm dy kategori të shpenzimeve ajo e pagave dhe mallra & shërbime. Shpenzimet e pagave në vitin 2023 ishin më të larta për 2.22 % krahasuar me vitin 2022, po ashtu edhe shpenzimet për Mallra dhe Shërbime në vitin 2023 ishin më të larta për 31.12 % më shumë se në vitin 2022.

DREJTORIA E BUJQËSISË


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet në Drejtorinë e Bujqësisë për vitet 2022 dhe 2023 ishin si në vijim: në kategorinë e pagave shpenzimet për vitin 2023 ishin për 12 % më shumë se në vitin 2022, në kategorinë e mallra & shërbimeve shpenzimet në vitin 2023 ishin më të vogla për 23.08 %, subvencionet në vitin 2023 ishin 0 € në krahasim me vitin 2022 të cilat ishin 544,033.72 €, ndërsa shpenzimet për investime kapitale në vitin 2023 janë rritur për 71.28 % më shumë krahasuar me vitin 2022.

DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet gjatë viteve 2022 dhe 2023 për Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit ekonomik ishin si vijon: në kategorinë e pagave shpenzimet në vitin 2023 ishin më të larta për 43.93 % krahasuar me vitin 2022, shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishin më të vogla për 3.16 % krahasuar me vitin 2022, ndërsa shpenzimet për investime kapitale në vitin 2023 ishin më të larta për 56.97 % krahasuar me vitin 2022.

DREJTORIA PËR KADASTËR DHE GJEODEZI


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi gjatë viteve 2022 dhe 2023 kishte vetëm dy kategori të shpenzimeve ajo e pagave dhe mallra & shërbimeve. Shpenzimet e pagave në vitin 2023 janë rritur për 23.98 % krahasuar me vitin 2022, po ashtu edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishin rritur për 89.46 % në krahasim me vitin 2022.

DREJTORIA E URBANIZMIT


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet gjatë viteve 2022-2023 në Drejtorinë e Urbanizmit ishin si vijon: në kategorinë e pagave shpenzimet për vitin 2023 ishin rritur për 28.93 % krahasuar me vitin 2022, po ashtu rritje më të theksuar kishte edhe në shpenzimet e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ku në vitin 2023 këto shpenzime ishin rritur për 104.04 % krahasuar me vitin 2022 ndërsa investimet kapitale ishin shpenzimet me rritjen më të lartë në vitin 2023 për 2550% krahasuar me vitin 2022.

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë viteve 2022 dhe 2023 kishte këto shpenzime: shpenzimet për paga në vitin 2023 ishin për 56.25 % më të larta se në vitin 2022, shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishin rritur në mënyrë të dukshme për 219.38 % krahasuar me vitin 2022, rritje të lartë të shpenzimeve në vitin 2023 vërehet edhe tek investimet kapitale me një rritje prej 196.49 % krahasuar me një vite më parë atë 2022, ndërsa shpenzime më të ulëta në të dy vitet kishte për subvencione ku në vitin 2023 shpenzimet për këtë kategori ishin rritur vetëm për 5.12 % krahasuar me vitin 2022.

DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Shpenzimet për dy vitet paraprake 2022 dhe 2023 në Drejtorinë për punë dhe mirëqenie sociale ishin si vijon: në kategorinë e pagave shpenzimet për vitin 2023 ishin për 2.93 % më të larta se në vitin 2022, shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishin për 16.20 % më të larta se në vitin 2022 ndërsa dy kategori të shpenzimeve të cilat kanë pasur ulje të shpenzimeve në vitin 2023 në raport me vitin 2022 ishin shpenzimet komunale dhe investimet kapitale përkatësisht me -46.75 % dhe -34.93 % më pak shpenzime se në vitin 2022.

DREJTORIA E ARSIMIT


KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Në Drejtorinë e Arsimit gjatë viteve 2022 dhe 2023 ishin këto shpenzime: shpenzimet në kategorinë e pagave gjatë vitit 2023 në DKA ishin rritur për 21.47 % krahasuar me një vite më parë atë 2022, shpenzimet kapitale po ashtu kanë pësuar rritje për 80.95 % në raport me vitin 2022 ndërsa dy kategori të shpenzimeve të cilat janë zvogëluar gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022 ishin shpenzimet për mallra dhe shërbime me -14.57 % më pak shpenzime se në vitin 2022 dhe shpenzimet komunale me -1.69 % më pak shpenzime se në vitin 2022.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

KRAHASIMI I SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE PËR VITET 2022-2023



Në Drejtorinë e Shëndetësisë shpenzimet në të gjitha kategoritë ishin rritur në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Shpenzimet në kategorinë e pagave në vitin 2023 ishin për 18.18 % më të larta se në vitin 2022, shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishin më të larta për 10.80 % krahasuar me vitin 2022, shpenzimet komunale po ashtu ishin rritur në vitin 2023 për 22.55 % krahasuar me vitin 2022 dhe në fund shpenzimet për investime kapitale në vitin 2023 ishin rritur për 12.80 % krahasuar me shpenzimet e vitit 2022.